



---

**Hapet thirrja për mobilitete studentësh dhe stafi të UPT-së,  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,  
në Riga Technical University, Letoni**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Riga Technical University – RTU.

**Lloji i mobilitetit përfshin:** Shkëmbimin e studentëve dhe stafit për një periudhë afatshkurtër në RTU, *Blended Intensive Programme (BIP) “Urban Iconography.”*

Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.

**Kohëzgjatja e bursave:** 1 javë, (Semestri i parë, i vitit akademik 2026-2027).

**Numri total i studentëve:** 5

**Numri total i stafit akademik:** 2

Numri përfundimtar i studentëve dhe stafit përcaktohet nga RTU.

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj;
- Dokumenti Learning Agreement.

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik/administrativ;
- Dokumenti Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training).

Aplikimi për studentët kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

**Afati për aplikim: Deri më 29 qershor 2026, ora 12.00**

Pas përfundimit të mobilitetit të stafit, personi pjesëmarrës në RTU duhet të dorëzojë një raport te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, lidhur me aktivitetin.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) , [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al)